


REPUBLIKA E SHQIPERISE

MINISTRIA E BUJQËSISË, USHQIMIT DHE MBROJTJES SË
KONSUMATORIT

SPECIFIKIME TEKNIKE

*“REHABILITIM I SHKARKUESIT TE KANALIT TE DIGES
SE REZERVUARIT KELCYRE”*



Tirane

SPECIFIKIMET TEKNIKE

1. Te per gjithshme

Paragrafet ne kete kapitull jane plotesues te detajeve te dhena ne Kushtet e kontrates

2. Pershkrim i per gjithshem i objektit

Ne objektin “Reabilitim i Sistemit Ujites V-2, V-3, V-3-4 Lazarat dhe Kanali Ujites te Rezervuarit Kelcyre” eshte parashikuar te kryhen investime qe ta riktheje sistemin e ujites ne kushtet e projektit pra ti beje kanalet funksionale duke permiresuar ujitjen e tokave bujqesore.

Zona per te cilen kekrohet kjo nderhyrje ne ujite ka nje sistem te ngritur te infrastruktures se ujites te gjithe fushes se Lazaratit prej 500 ha ne teresi e cila ka funksionuar normalisht deri ne vitet 90. Me pas ky rrjet eshte neglizhuar edhe nuk eshte mbajtur ne eficence edhe per shkak te mungeses se fondeve te mjaftueshme per rehabilitimin e ketyre kanaleve dhe mirembajtjen e tyre.

Kanali ujites V-2 parashikon rehabilitimin e tij ne nje gjatesi prej 3 km dhe eshte vazhdim i fazes se pare te rehabilitimit te tij deri ne afersi te fabrikes se Amites. Ky kanal kryesor ujites ve nen uje nje siperfaqe toke prej 1500 ha toke bujqesore. Rehabilitimi i kanalit ujites V-3 kap nje gjatesi prej 2.8 km dhe kanali ujites V-3-4 kap nje gjatesi prej 3 km dhe ve nen uje nje siperfaqe prej 500 ha. Kanali i Kelcyres merr uje nga rezervuari i Kelcyres, me kapacitet ujembledhes 735000m³ uje, dhe ujit nje siperfaqe prej 250ha. Kanali ka dy dege me nje gjatesi ne total prej 5.5km. Gjatesi e kanalit qe do te rehabilitohet eshte 4.5km, krahu i majte: nga rezervuari te fabrika e tullave dhe krahu i djathje nga rezervuari deri te stacioni i pompave.

3. Zevendesimet

Zevendesimi i materialev te specifikuara ne Dokumentin e Kontrates do te behen vetem me aprovin e Mbikeqyresit te Punimeve ne se materiali i propozuar per tu zevendesuar eshte i njeje ose me i mire se materialet e specifikuara ; ose ne se materialet e specifikuara nuk mund te sillen ne sheshin e ndertimit ne kohe per te perfunduar punimet e Kontrates per shkak te kushteve jashte kontrollit te Sipermarresit. Qe kjo te merret ne konsiderate, kerkesa per zevendesim do te

shoqerohet me nje dokument deshmi te cilesise , ne formen e kuotimit te certifikuar materialit te specifikuar ashtu edhe te atij qe propozohet te ndryshohet.

4. Dokumentat dhe vizatimet

Sipermarresi do te verifikoje te gjitha dimensionet, sasite dhe detajet te treguara ne Vizatimet, Grafiket, ose te dhena te tjera dhe Punedhenesi nuk do te mbaje perjegjesi per ndonje mangesi ose mosperputhje te gjetur ne to. Mos zbulimi ose korigimi i gabimeve ose mosperputhjeve nuk do ta lehtesoje Sipermarresin nga perjegjesia per pune te pakenaqeshme . Sipermarresi do te marre persiper te gjithe perjegjesine ne berjen e llogarive te madhesive, llojeve dhe sasive te materialeve dhe pajisjeve te perfshira ne punen qe duhet bere sipas Kontrates. Ai nuk do te lejohet te kete avantazhe nga ndonje gabim ose mosperputhje, ndersa nje udhezim i plote do te jepet nga Punedhenesi ne se gabime te tilla ose mosperputhje do te zbulohen.

5. Kostot e Sipermarresit per punime te perkohshme

Do te kihet parasysh qe Sipermarresit nuk do te behet asnje pagese shtese mbi cmimet njesi te kuotuara per kostot e zerave te ndryshem para e gjate ndertimit te objektit d.m.th. per sigurimin e transportit, drite, energjine, veglat dhe pajisjet,ose per furnizimin e godines dhe mirembajtjen e impjanteve te ndertimit, rrugeve te hyrjes, te komoditeteve sanitare heqje e mbeturinave, punen, furnizimin me uje, mbrojtjen kundra zjarrit, bangot e punes, rojet, rrjetin telefonik si dhe struktura te tjera te perkoheshme, pajisje dhe materiale, ose per kujdesin mjeksor dhe mbrojtjen e shendetit, ose per patrullat dhe rojet, ose per ndonje sherbim tjeter, lethesi, gjera, ose materiale te nevojshme ose qe kerkohen per zbatimin e punimeve ne perputhje me ate qe eshte parashikuar ne Kontrate.

6. Piketimi i punimeve

Sipermarresi, me shpenzimet e tij duhet te beje ndertimin e modinave dhe te piketave sic kerkohet, ne perputhje me informacionin baze te Punedhenesit, dhe do te jete perjegjesi i vetem per perpikmerine.

Sipermarresi do te jete perjegjes per te kontrolluar dhe verifikuar informacionin baze qe i eshte dhene dhe ne asnje menyre nuk do te lehtesohet nga perjegjesia e tij ne se nje informacion i tille eshte i manget, jo autentik ose jo korrekt. Ai nderkohe do te jete subjekti qe do te kontrollohet dhe rishikohet nga Punedhenesi dhe neasnje rast nuk i jepet e drejta te beje ndryshime ne vizatimet e kontrates, per asnje lloj kompensimi per korigimet e gabimeve ose te mangesive.

Sipermarresi do te ruaje te gjitha pikat e akseve, modinat, shenjat e kuotave, te bera ose te vendosura gjate punes, te mbuloje koston e rivendosjes se tyre nese ato demtohen dhe te mbuloje te gjitha shpenzimet per ndreqjen e punes se bere jo mire per shkak te mosmirembajtjes ose mbrojtjes ose spostimit pa autorizim te ketyre pikave te vendosura, modinave dhe piketave

Cdo pune e bere jashte akseve, kuotave dhe kufinjve te treguara ose te mosmiratuara nga Punedhenesi nuk do te paguhet, dhe Sipermarresi do te mbuloje me shpenzimet e tij germimet shtese gjithmone nen drejtimin e Mbikqyresit te Punimeve.

7. Fotografite e sheshit te ndertimit

Sipermanresi duhet te beje fotografë sipas udhezimeve te Mbikeqyresit te Punimeve ne vendet e punes per te demostruar kushtet e sheshit perpara fillimit, progresin gjate punes se ndertimit dhe mbas perfundimit te punimeve. Nuk do te behen pagesa per fotografimin e kantierit te punimeve pasi keto shpenzime jane parashikuar te mbulohen nen koston administrative te Sipermanresit.

8. Bashkepunimi ne zone

Ndertimi do te behet ne zona te kufizuara. Sipermanresi duhet te kete vecanerisht kujdeset ne:

- Nevojiten per te mirembajtur sherbimet ekzistuese dhe mundesite e kalimit per banoret dhe tregetaret qe jane ne zone, gjate periudhes se ndertimit.
- Prezencen e mundshme te kontraktoreve te tjere ne zone me te cilet do te koordinohet puna.

E gjithe puna, do te behet ne nje menyre te tille, qe te lejoje hyrjen dhe perballimin e te gjithe pajisjeve te mundshme per ndonje Kontraktor tjeter dhe punetoreve te tij, stafin e Punedhenesit si edhe te cdo te punonjesit qe mund te punesohez ne zbatim dhe ose punimet ne zone ose prane saj per cdo objekt qe ka lidhje me Kontranaten ose cdo gje tjeter.

Ne pregatitjen e programit te tij te punes, Sipermanresi gjate gjithe kohes do te beje llogari te plete dhe te kooperoje me programin e punes se Kontraktoreve te tjere, ne menyre qe te shkaktoje nje minimum interference me ta dhe me publikun.

9. Mbrojtja e punes dhe e publikut

Sipermanresi do te marre masa paraprake per mbrojtjen e punetoreve te punesaai dhe te jetes publike. Masat e sigurimit paraprak te ligjeve te aplikueshme, kodeve te ndertimit do te respektohen.

Gjate zbatimit te punimeve Sipermanresi, me shpenzimet e veta, duhet te vendosi dhe te mirembaje gjate nates pengesa te tilla dhe drita te cilat do te parandalojne ne menyre efektive aksidentet.

10. Mbrojtja e ambjentit

Sipermanresi me shpenzimet e vete, duhet te ndermarre te gjitha veprimet e mundshme per te siguruar mbrojtjen e ambientit lokal te sheshit te ndertimit.



11. Germim dheu me makineri pastrim kanali prani uji shkarkim ne toke

Keto punime parashikohen te realizohen me makineri ne toke te kategorise se trete ne prani uji dhe konsistojne ne pastrimin e kanalit nga aluvionet e depozituara brenda seksionit terthor te tij. Materiali i germuar eshte parashikuar te hidhet ne krahun e majte te kanalit pa bllokuar rrugen per kalimin e mjeteve te fermereve.

12. Germim dheu ulje bankine me eskavator 0.25 m³

Ketu perfshihen punimet e uljes se bankines ne menyre qe te kaloj dhe te punoj eskavatori per pastrimin e kanalit kullues. Ktu dherat parashikohen te perhapen uniformisht gjate gjithe gjatesise se kanalit ku do te behet pastrimi.

13. Rrafshim dheu skrapat me makineri.

Ketu eshte parashikuar rrafshimi me makineri i skrapatave me trashesi 10 cm gjate gjithe gjatesise se kanaleve qe do pastrohen. Shkarkimi i dherave do behet ne toke.

14. Germim dheu me makineri pastrim kanali prani uji shkarkim ne mjete

Keto punime parashikohen te realizohen me makineri ne toke te kategorise se trete ne prani uji dhe konsistojne ne pastrimin e kanalit nga aluvionet e depozituara brenda seksionit terthor te tij. Materiali i germuar eshte parashikuar te hidhet ne mjet pasi ai do te transportohet .

15. Pastrim dheu me krahe

Keto punime jane parashikuar te realizohen ne toke te kategorise se trete dhe konsistojne ne pastrimin e kanalit nga dherat e depozituara ne te me krahe, dhera te cilat duhet te hidhen jashte bankines se kanalit.

16. Prerje bime te vogla O-10 CM

Ketu eshte parashikuar te behet prerja e bimeve te vogla me diameter deri 10 cm gjate gjithe gjatesise se kanalit.

17. Heqja e materialeve te teperta nga germimi

I gjithe materiali i tepert i germuar nga Sipermarresi do te largohet ne vendet e aprovuara.

18. Transport dhera me makineri deri 1 km dhe magazinimi i materialeve

Ketu ne kete ze jane parashikuar ngarkimi i dherave me makineri , transporti i ketij materiali me auto deri 1 km . Transporti i materialeve nga Sipermarresi do te behet me makina te pershtateshme te cilat kur ngarkohen nuk shkaktojne derdhje dhe e gjithe ngarkesa te jete e siguruar. Ndonje makine qe nuk ploteson kerkese ose ndonje nga rregullat ose ligjet e qarkullimit do te hiqen nga kantjeri. Te gjitha materialet qe sillen nga Sipermarresi, duhet te sistemohen ne menyre te pershtatshme per ti mbrojtur nga rreshqitjet, demtimet, vjedhjet dhe ne dispozicion, per tu kontrolluar nga Mbikeqyresi i Punimeve ne cdo kohe.

19. Matjet

Te gjitha zerat e germimeve do te maten ne volum. Matja e volumit te germimeve do te bazohet ne dimensionet e marra nga vizatimet ne te cilat percaktohen permasat e germimeve. Matja e volumit te gaboneve do te bazohet ne dimensionet e marra nga vizatimet e projekteve dhe matja faktike.

20. Kopjimi i vizatimeve (sic eshte zbatuar).

Sipermarresi duhet te pergatise vizatimet per te gjitha punimet "sic Jane faktikisht zbatuar" ne terren. Vizatimet do te behen ne nje standart te ngjashem me ate te vizatimeve te Kontrates.

Gjate zbatimit te punimeve ne kantier, Sipermarresi do te ruaje te gjithe informacionin e nevojshem per perqatitjen e "Vizatimeve sic eshte zbatuar".

Do te shenoje ne menyre te qarte vizatimet dhe te gjitha dokumentat e tjera te cilat mbulojne punen e vazhdueshme te perfunduar, material i cili do te jete i disponueshem ne cdo kohe gjate zbatimit.

Keto vizatime do te azhornohen ne menyre te vazhdueshme dhe do t'i dorezohen Mbikqyresit te Punimeve cdo muaj per aprovim, pasi Punimet te kene perfunduar, sebashku me kopjen perfundimtare.

Si perfundim, kopjet e riproduhuara te Vizatimeve " sic eshte zbatuar" do t'i dorezohen Mbikqyresit te Punimeve per aprovim. Vizatimet "sic eshte zbatuar" ,te aprovuara, do te behen prone e Punedhenesit.

Nuk do te behen pagesa per berjen e Vizatimeve "sic eshte zbatuar" dhe Manualeve, pasi kosto e tyre eshte parashikuar te mbulohet nga shpenzimet administrative te Sipermarresit.

21. Pastrimi perfundimtar i zones.

Ne perfundim te punes, sa here qe eshte e aplikueshme Sipermarresi, me shpenzimet e tij, duhet te pastroje dhe te heqe nga sheshi te gjitha materialet qe kane tepruar, mbeturinat te cdo lloji dhe te lere sheshin ne kondita te pranueshme. Pagesa perfundimtare e Kontrates do te mbahet deri sa kjo te realizohet dhe pasi te jepet miratimi nga Mbikqyresi i Punimeve.

Shenime teknike

- **Keto shenime teknike jane pjese perberese e projektit dhe do te lexohen se bashku me fletet e tjera te projektit .**
1. Projekti eshte hartuar duke u bazuar ne azhornimet topografikete kryera ne muajin Gusht 2011.
 2. Profili gjatesor dhe terthor eshte dhene ne projekt per cdo kanal dhe prite dhe te ndertohet ne perputhje me parametrat e dhena aty.
 3. Perpara fillimit te punimeve nga ana e zbatuesit , duhet te behet piketimi dhe azhornimi i profilit gjatesor te kanalit dhe prites dhe ne asnje rast nuk duhet te fillohet nga puna pa u bere konfirmimi nga supervizori dhe venia ne dijeni e projektuesit.
 4. Kontaktori duhet ti japi supervizorit te pakten 7 dite me pare njoftimin e tij per te filluar punimet e germimit te dherave ne cdo pjese te kantjerit(vendit ku do te zhvillohen punimet)ne menyre qe ti japi mundesi supervizorit te verifikoj kuotat perkatese ose vecorit e tjera te vendeve te punes.Punimet e dherave te permendura nuk mund te fillojne pa marre miratimin me shkrim nga supervizori.Ato do te kryhen sipas permasave dhe kuotave te dhena ne vizatimet e projektit dhe specifikimet ose sipas atyre qe jep supervizori.
 5. Per cdo ndryshim ne zbatimin e projektit te merret miratimi me shkrim nga supervizori, projektuesi dhe te behet konfirmimi zyrtar prane drejtorese teknike te investitorit dhe prane bordit.

Zbatimi i te gjitha punimeve te parashikuara ne projekt preventiv do te behet duke u bazuar ne menyre rigorozne "Kushtet teknike te zbatimit te punimeve".duke perdorur materiale sipas standardeve ne fuqi.